



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE
DREJTORIA MONITORIMIT

Lënda: Kthim Përgjigje

Në përgjigje tuajës me Nr. 2402/ 02.12.2024 prot., me lëndë “Kërkesë për informacion” ju sqarojmë si më poshtë:

1. Sa është numri i kompanive minerare që ushtrojnë aktivitetin në sektorin minerar në Shqipëri? Cilat janë këto kompani?
 - Numri i subjekteve minerare që ushtrojnë aktivitet minerar në Shqipëri bazuar në kërkesat dhe parashikimet ligjore të Ligj Nr.10 304 datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) është 542 si dhe 45 janë subjekte nënkontraktorë të miratuar nga MIE.
 - Të gjitha subjektet minerare i gjeni të regjistruara me të dhënat përkatëse pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.
2. A ka kompani minerare në Shqipëri që ushtrojnë veprimtarinë e tyre pa licence? Nëse po, ju lutem specifikojeni rastet që keni zbuluar? Mund të na vini në dispozicion dokumentacion për këtë?
 - AKBN në zbatim të ligjit Nr.10 304 datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore të nxjerra në funksion dhe për zbatim të tij, monitoron dhe mbikqyr të gjitha lejet minerare aktive për të gjithë subjektet që janë të pajisur me liçencë dhe ushtrojnë aktivitet minerar.
3. Cilat janë kompanitë minerare që keni monitoruar gjatë vitit 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe çfarë shkeljesh keni gjetur? Ju lutem na dërgoni raportet!
 - Për vitin 2020 nga 580 leje minerare janë monitoruar 438 prej tyre.
Për vitin 2021 nga 597 leje minerare janë monitoruar 497 prej tyre.
Për vitin 2022 nga 576 leje minerare janë monitoruar 479 prej tyre.
Për vitin 2023 nga 562 leje minerare janë monitoruar 221 prej tyre.
Për 6-mujorin e parë të vitit 2024 nga 587 leje minerare janë monitoruar 312 prej tyre.

Shënim: Subjektet minerare për të cilat nuk është kryer monitorimi kanë qënë në pezullim të përkohshëm të aktivitetit minerar bazuar në Nenin 18 të Ligjit Nr.10 304 datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

Në zbatim të Nenit 31 te ligjit Nr.10 304 datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar):

- Për vitin 2020 janë propozuar për revokim, 21 leje minerare për mospagesë të garancisë financiare të rehabilitimit .
Për vitin 2021 propozuar për revokim, 25 leje minerare për mospagesë të garancisë financiare të rehabilitimit.
Për vitin 2022 propozuar për revokim, 39 leje minerare për mospagesë të garancisë financiare të rehabilitimit.
Për vitin 2023 propozuar për revokim, 18 leje minerare për mospagesë të garancisë financiare të rehabilitimit.
Për 6-mujorin e parë të vitit 2024 propozuar për revokim, 13 leje minerare për mospagesë të garancisë financiare të rehabilitimit.

4. Cilat janë kompanitë minerare që nuk zbatojnë rregullin për ripyllëzimin e pjesëve të dëmtuara? Për cilat miniera bëhet fjalë, sipas zonave dhe emrave përkatës?

Subjektet titullarë të lejeve minerare të shfrytëzimit nuk kanë kryer rehabilitimin e sipërfaqes së prekur, pasi janë në zhvillim e sipër të aktivitetit minerar. Subjektet private, që zotërojnë këto leje minerare, janë në aktivitet shfrytëzimi për të paktën edhe 6 vite të tjera (Lejet minerare që janë në 10 vjeçarin e III-të të aktivitetit minerar). Të gjitha subjektet minerare, në zbatim të Nenit 31 ligjit Nr.10 304 datë 15.07.20210, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) kanë detyrimin ligjor të depozitojnë pranë thesarit të shtetit, vlerën monetare vjetore të Garancisë së Rehabilitimit të Mjedisit, të përcaktuar në projektin e shfrytëzimit dhe Akt Miratimin përkatës, për vitin pasardhës të aktivitetit minerar. Kjo vlerë do të shërbejë si garanci e autoritetit kontraktor për rehabilitimin e sipërfaqes së prekur nga aktiviteti minerar në ato raste kur vetë subjekti nuk e realizon atë pas përfundimit të aktivitetit të shfrytëzimit.

5. A keni mungesa në staf për Specialist në Sektorin e Monitorimit Minerar që monitorojnë në terren aktivitetit e kompanive minerare?
- Në Drejtorinë e Monitorimit pranë AKBN nuk ka mungesë stafi për monitorimin në terren të aktivitetit minerar.

DREJTORIA E MONITORIMIT